



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 201601382/7

Tiranë ____/____/2016

Lënda: *Rekomandohet zgjidhja e mosmarrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave për rastin e mjekëve specializantë të kontraktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Instituti i Mjekësisë Ligjore*

Drejtuar: **Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë**
 Z. Edi RAMA

TIRANË

I nderuar Z. Kryeministër,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë paraqitur ankesë mjekët specializantë të kontraktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në vitin 2015 për të kryer shërbim në burgje për një periudhë 3 dhe 5 vjeçare pas përfundimit të specializimit. Kontrata është lidhur në bazë të VKM Nr.763, datë 12.11.2014 dhe përcakton se mjekët specializantë duhet të trajtohen financiarisht gjatë periudhës së studimeve. Dega e Thesarit Tiranë ka ndërprerë pagesën e tyre me kërkesë të Ministrisë së Financave që nga Muaji Tetor 2015 me pretendimin se ligjislacioni nuk parashikon trajtim financiarë të mjekëve specializantë të kontraktuar nga Ministria e Drejtësisë. Paga është ndërprerë edhe për mjekët specializantë të kontraktuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore.

Nga hetimi që kemi kryer për këtë rast rezulton se, kjo situatë është krijuar nga mosmarrëveshja që ka lindur ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave për arsye të interpretimeve të ndryshme që i bëhen VKM Nr.763, datë 12.11.2014, pika 13 dhe 15.

Sipas Ministrisë së Drejtësisë, VKM Nr.763/2014 i njuh të drejtën kësaj ministrie për të lidhur kontratë me mjekët specializantë dhe të përcaktojë detyrimet mes palëve. Në zbatim të kësaj VKM-je Ministria e Drejtësisë ka përcaktuar në kontratë se, DPBurgjeve dhe Instituti i Mjekësisë Ligjore duhet të garantojnë trajtimin financiarë të specializantëve gjatë periudhës studimore.

Sipas Ministrisë së Financave, VKM Nr.763/2014 nuk parashikon trajtim financiarë të mjekëve specializantë të kontraktuar nga Ministria e Drejtësisë dhe në VKM Nr.555, datë 11.08.2011 është miratuar nivel page vetëm për

mjekët specialistë të kontraktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe strukturat e Forcave të Armatosura.

Ndërsa Ministria e Arsimit dhe Sportit, që ka propozuar VKM Nr.763/2014, shprehet se duhet të zbatohen detyrimet kontraktore të lindura ndërmjet palëve dhe për zgjidhjen e shpejtë të problemit sugjeron të ndryshohet VKM Nr.23, datë 20.01.2016 *“Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2016 në njësitë e qeverisjes qendrore”*.

I nderuar Zoti Kryeministër, problemi i mjekëve specialistë vazhdon të mbetet i pazgjidhur dhe ankesa e tyre mund të bëhet objekt shqyrtimi në gjykatë. Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët (neni 690 i Kodit Civil). Mjekët specialistë mund të kërkojnë dëmshpërblim për mosrespektimin të detyrimit kontraktor për trajtimin e tyre financiarë edhe nëse ky detyrim gjykohet i pavlefshëm nga Ministria e Financës, pasi ata kanë qenë në mirëbesim për vlefshmërinë e tij (neni 674 i Kodit Civil). Gjithashtu, për shkak të mos respektimit të detyrimit kontraktorë, mjekët specialistë mund të mos pranojnë të shërbejnë në Institutin e Mjekësisë Ligjore apo në burgje pas përfundimit të periudhës së studimeve duke cënuar cilësinë e shërbimit mjekësor që do ti ofrohet qytetarëve në këto institucione (në kontratën e lidhur ndërmjet IML, DPBurgjeve dhe mjekëve specialistë përcaktohet se: *“Në rast se Znj/Z____, pas përfundimit të studimeve ose ndërprerjes së kontratës për arsye që varen nga vetë personi, nuk kthehen menjëherë në dispozicion të shërbimit mjekësor të IML apo DPBurgjeve ose shmangen nga ky detyrim....., detyrohen të kthejnë shumën monetare që ai/ajo ka përfituar në formën e pagesës mujore....”*).

Bashkëlidhur me këtë rekomandim do të gjeni fotokopje të shkresave ku shprehet qëndrimi i Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit si dhe të kontratës të lidhur me mjekët specialistë.

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63/ 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në Nenin 27/2/a të Ligjit Nr.44./2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”* ku përcaktohet se, Kryeministri zgjidh konfliktet ndërmjet ministrive të ndryshme në rast se ato nuk arrijnë në një marrëveshje,

J U R E K O M A N D O J M Ë:

Zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave për rastin e mjekëve specialistë të kontraktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Instituti i Mjekësisë Ligjore.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI